

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË ZBATIMIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Adresa Rruga “M.Gjolllesha”, ish Instituti i Ndertimit (pranë IKMT), Tiranë
Tel/Faks +355 4 234885
E-mail prokurimet@albaniandf.org
Ueb-faqe www.albaniandf.org

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri L.Halimi
E-mail prokurimet@albaniandf.org.

3. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedure e Hapur Marreveshje Kuader.

4. Lloji i kontratës /Marreveshjes kuader: Punë publike.

5. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF- 33156-06-16-2022

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Ndërhyrje për përmirësimin e strukturave dhe mbrojtjeve rrugore – paketa e rreshqitjeve dhe mbrotjeve.

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Punë Ndërtimi- 45000000-7.

8. Fondi limit: 416,666,666 lekë, pa TVSH

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë:

Neni 127 të LPP pika 1/c ku parashikohet; “Kontrata publike apo marrëveshja kuadër mund të modifikohet pa zhvilluar një procedurë të re prokurimi në rastet e mëposhtme: c) kur modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike apo të marrëveshjes kuadër”.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e punimeve

Për shkak se:

a. Duke marrë në konsideratë kërkesat e bashkive nëpërmjet thirrjes së hapur nga FSHZH, nevoja për përmirësimin e strukturave dhe mbrojtjeve rrugore është rritur përtej fondit të marrëveshjes..

b. Me shkresë nr. 9/1 Prot., datë 06.01.2023 të FSHZH-së është kërkuar miratimi i detajimit të buxhetit për infrastrukturën rajonale vendore në kuadër të programit operacional.

c. Me shkresë nr. 23774/61 Prot., datë 20.1.2023 të MFE është miratuar detajimi i buxhetit për shpenzimet kapitale për infrastrukturën rajonale vendore.

d. Për të bërë të mundur ndërhyrjen dhe përmirësimin e strukturave dhe mbrojtjeve rrugore, vlera aktuale e MK nuk i mbulon punimet shtesë. Modifikimi i vlerës nuk e ndryshonë në thelb natyrën e saj.

Bazuar në:

a) Neni 127 të LPP pika 1/c ku parashikohet; “Kontrata publike apo marrëveshja kuadër mund të modifikohet pa zhvilluar një procedurë të re prokurimi në rastet e mëposhtme: c) kur modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike apo të marrëveshjes kuadër”.

b) Faktin që vlera monetare e modifikimit, nuk e tejkalon 20% të vlerës së marrëveshjes dhe nuk e ndryshon në thelb natyrën e saj.

c) Kërkesën dhe relacionin për amendim të Marrëveshjes Kuadër të miratuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Programeve, modifikohet vlera totale me vlerën shtesë 83,333,333 lekë pa TVSH.

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: 416,666,666 lekë, pa TVSH

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): 499,999,999 lekë pa TVSH

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: 24 muaj

Dhe afati i ri (nëse është rasti): _____

14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomik:

“ALB-BUILDING” shpk, NUIS J69102508C me adresë: Rruga “Asim Vokshi”, ndërtesa nr. 14, hyrja 4, ap. 6, Tiranë.

15. Data e nënshkrimit të modifikimit: 03.2.2023

16. Burimi i financimit: Buxheti Shtetit

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor: _____